



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

PËR SHQYRTIMIN E PROPOZIMIT PËR NDRYSHIMIN E VENDIT TË NUMËRIMIT TË VOTAVE TË ZAZ-SË NR. 67, QARKU KORÇË, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30.06.2019

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 25.06.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI	Kryetar
Denar	BIBA	Zëvendëskryetar
Bledar	SKËNDERI	Anëtar
Edlira	JORGAQI	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për shqyrtimin e propozimit për ndryshimin e vendit të numërimit të votave të zaz-së nr. 67, Qarku Korçë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1 germa "a", nenin 93 dhe 94, pika 1 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

V Ë R E N

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr.368 datë 15.05.2019, ka miratuar caktimin e VNV së KZAZ nr.67 në Këndin e lojrave me dorë "Arefi Berberi", me sipërfaqe prej 300 m2, Bashkia Pogradec.

Bashkia Pogradec, me shkresat nr. 4641, datë 14.06.2019, nr. 4690/1 prot., datë 19.06.2019, drejtuar KZAZ nr. 67, për dijeni KQZ, Prefektit të Qarkut Korçë, ka kërkuar lirim të menjëhershëm të ambjentëve që janë në administrim të saj, të cilat janë përcaktuar për tu vënë në dispozicion të KZAZ nr. 67 për zgjedhjet e datës 30.06.2019.

Prefekti i Qarkut Korçë, në vlerësim situatës dhe bazuar në ligjin nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", me shkresën nr.12280 prot., datë 24.06.2019, propozon ndryshimin e vendndodhjes së VNV-së së ZAZ nr. 67 duke e caktuar në ambient privat "Godinë dhe



Nr. 866 i Vendimit Data 25.06.2019 e Vendimit Ora 13:00 e Vendimit

Për shqyrtimin e propozimit për ndryshimin e vendit të numërimit të votave të zaz-së nr. 67, Qarku Korçë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019

palestër sportive”, me adresë Rruga Nationale Pogradec-Tiranë, km 4, Njësia Administrative Udenisht, Bashkia Pogradec.

Ambienti i propozuar ndodhet brenda territorit të Zonës së Administrimit Zgjedhor, plotëson kriteret e parashikuara në nenin 93 dhe 94 të Kodit Zgjedhor “Në përcaktimin e Vendit të Numërimit të Votave KQZ-ja mund të përzgjedhë bashkinë qendër qarku, pavarësisht nëse ndodhet jashtë juridiksionit territorial të ZAZ-së, ose bashkinë brenda territorit të ZAZ-së apo edhe njësinë më të madhe administrative, nëse bashkitë nuk i plotësojnë kushtet e parashikuara në nenin 93 dhe në këtë nen”.

Gjithashtu, ambienti i propozuar ka sipërfaqe mbi 300 m², duke plotësuar kriteret e Udhëzimit nr. 4, datë 9.04.2015, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për mënyrën e caktimit dhe organizmit të Vendit të Numërimit të Votave, kriteret për caktimin e numrit të grupeve të numërimit për çdo vend të numërimit të votave, për caktimin e rregullave për ndarjen e detyrave midis anëtarëve të grupeve të numërimit”.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1 germa “a”, nenin 93 dhe 94, pika 1 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar:

V E N D O S I

1. Të caktojë Vendin e Numërimit të Votave të ZAZ-së nr. 67, në “Godinë dhe palestër sportive”, Njësia Administrative Udenisht, Bashkia Pogradec.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI	Kryetar
Denar	BIBA	Zëvendëskryetar
Bledar	SKËNDERI	Anëtar
Edlira	JORGAQI	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare



Nr. 866 i Vendimit Data 25.06.2019 e Vendimit Ora 13:00 e Vendimit

Për shqyrtimin e propozimit për ndryshimin e vendit të numërimit të votave të zaz-së nr. 67, Qarku Korçë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019